



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës tuaj

**ZNJ.** \_\_\_\_\_

Në përgjigje të shkresës tuaj kërkesë për informacion administruar nga Bashkia Shkoder me nr.2891 Prot, datë 12.02.2024 ju bëjmë me dije se:

Bashkia Shkodër ofron shërbime me bazë komunitare nëpërmjet Qendrave Komunitare “Për Familjen” që mbulojnë me shërbime sociale çdo lagje të qytetit dhe njësitë administrative.

Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, të pastrehët, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Gjatë punës sonë përveç qendrave komunitare “Për Familjen” që ofrojnë shërbime sociale bazë në një territor të përcaktuar, kemi arritur të ndërtojmë qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për grupe dhe individë në nevojë të tilla si: qendra komunitare Multifunksionale në shërbim të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge; qendra komunitare “Për Familjen” nr. 6 me apartamente sociale për jetimët dhe familjet me një kryefamiljar dhe fëmijë.

Gjithashtu, është rikonstruktuar ish godina e kopshtit “Guerrile”, në zbatim të projektit ESERE “Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për përfshirjen sociale” ku ofrohen disa shërbime si: kopsht dhe çerdhe, zyra administrative dhe qendër shëndetësore për komunitetin e lagjes Nr.1. Ka përfunduar rikonstruksioni i godinës së ish shkollës Veterinare me synim krijimin e hapësirave për krijimin e një qendër komunitare “Për Familjen”, qendër shëndetësore për lagjen, kopsht&çerdhe dhe zyrë administrative të bashkisë Shkodër.

Në fushën e strehimit social, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar Bashkia Shkodër ka zbatuar disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familjet në nevojë për strehim. Subvencionimi i interesave të kredisë dhe subvencionimi i qirasë në tregun e lirë) për të cilat janë miratuar me vendim të këshillit bashkiak përfituesit. Gjithashtu janë zbatuar disa projekte që kanë si synim përmirësimin e kushteve të banimit për individë dhe familje në nevojë siç janë: Godinat sociale për komunitetin rom, Rikonstruksioni i godinës së ish konviktit të shkollës veterinare.

Sa i përket kategorisë së të pastrehëve, specialistët e qendrave komunitare i kanë orientuar, këshilluar madje dhe shoqëruar në zyrat e punës dhe të formimit profesional.

Të shpeshta kanë qënë rastet ku kësaj kategorie janë ofruar vende pune edhe në shërbimet publike të Bashkisë të cilat janë pranuar nga qytetarët po kemi edhe raste të cilat janë refuzuar.

Në 6 mujorin e fundit nga të pastrehet që kemi të strehuar në banesat sociale janë referuar 45 banorë, nga të cilët 4 të pastrehë janë sistemuar në shërbimet publike të bashkisë. Nga qendrat komunitare janë orientuar rreth 65 të pastrehë.

Në lidhje me referimet në Zyrën e punës, i janë ofruar opsione dhe alternativa të ndryshme kryesisht në sektorin privat deri tek punësimi i mbështetur, edukimi dhe trajnimi profesional.

Alternativat, iniciativat e punësimit duke qënë të kufizuara në shtrirje dhe kohën e tyre nuk ofrojnë zgjidhje afatgjata.

Të pastrehët përballen me pengesa të shumta në aksesin dhe iniciativat përkatëse të punësimit duke përfshirë këtu barrierat personale (shëndeti, nivele të ulëta të arsimimit, aftësitë profesionale); institucionale (barriera burokratike për nxjerrjen e dokumentacioni, punësim i përkohshëm, paga të paqëndrueshme)dhe shoqërore( diskriminimi), faktorë të cilët dekurajojnë këtë kategori për një punësim të qëndrueshëm të tyre.

Të pastrehët në situatë rruge janë shpesh në gjendje shumë të keqe të shëndetit mendor dhe fizik dhe mund të kenë nevojë fillimisht për mbështetje para se të angazhohen në shërbimet e punësimit. Kështu që ne duhet të punojmë për përmirësimin e zhvillimit të aftësive dhe kompetencave që ndihmojnë individin për t'u lidhur me punësimin në përgjithësi, gjë që realizohet me mbështetjen e shoqatave dhe organizatave që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër do të ketë në fokus ofrimin e shërbimeve për të qënë sa më afër kësaj shtrese vulnerabël.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

**KRYETAR**

**Benet BECI**